

## Njoftim Specifik i Prokurimit

# Kërkesë për Oferta Shërbime Jokonsulente

**Punëdhënësi:** Agjencia Kadastrale e Kosovës

**Projekti:** Projekti i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP)

**Titulli i kontratës:** Konvertimi, ngarkimi dhe përditësimi i të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit Ndërtesave.

**Shteti:** Republika e Kosovës

**Nr. i Kredisë:** IDA-63540

**RFB Nr:** XK-KCA-424029-NC-RFB

**Publikuar më:** 06 Qershor 2024

1. Qeveria e Kosovës (QK) ka marrë financim nga Banka Botërore për koston e Projektit të Kadastrit të Pronës së Paluajtshme dhe Infrastrukturës Gjeohapësinore (REGIP), dhe synon të shfrytëzojë një pjesë të të ardhurave për pagesat sipas kontratës për “Korrigjimin, ngarkimin dhe përditësimin e të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit Ndërtesave”.
2. Agjencia Kadastrale e Kosovës tani bën kërkesë për oferta të mbyllura nga ofertuesit e kualifikuar për “Korrigjimin, ngarkimin dhe përditësimin e të dhënave hapësinore në SIKTK-HK nga projektet e Kadastrit Ndërtesave”.
3. Ofertimi do të kryhet nëpërmjet prokurimit konkurrues ndërkombëtar duke përdorur Kërkesën për Oferta (KO) siç specifikohet në “Rregulloret e Prokurimit për Huamarrësit e FPI-së” të Bankës Botërore, të nxjerra në korrik të vitit 2016, dhe të rishikuara në nëntor të vitit 2017 dhe gusht të vitit 2018 (Rregulloret e Prokurimit” dhe është e hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar (ose vetëm për ofertuesit e parakualifikuar sipas rastit) siç përcaktohet në Rregulloret e Prokurimit.
4. Ofertuesit e interesuar të kualifikuar mund të marrin informacion të mëtejshëm nga: **Agjencia Kadastrale e Kosovës**

Për vëmendje të: Specialisti i Prokurimit, REGIP.

Adresa: rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, Objekti i Arkivit, kati 2, 10 000,

Prishtinë, Republika e Kosovës

Email: [prokurimi.regip@rks-gov.net](mailto:prokurimi.regip@rks-gov.net), dhe të kontrollojnë dokumentin e ofertimit gjatë orarit të punës (09:00-16:00) në adresën e dhënë më poshtë.

Adresa: Ndërtesa e Arkivit, kati 2, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

5. Dokumenti i tenderimit në gjuhën angleze mund të merret pa pagesë nga ofertuesit e interesuar të kualifikuar pas paraqitjes së kërkesës me shkrim në adresën e mëposhtme:

**Për vëmendje të:** Specialisti i Prokurimit, REGIP.

**Email:** [prokurimi.regip@rks-gov.net](mailto:prokurimi.regip@rks-gov.net)

6. Ofertat duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme më ose para datës 10.07.2024 në orën 14:00 (koha lokale). Ofertimi elektronik nuk do të lejohet. Ofertat pas afatit do të refuzohen. Në pjesën e jashtme të zarfi, Oferta duhet të përmbajë shënimin “OFERTA ORIGJINALE” ndërsa zarfet e brendshëm shënimin “PJESA TEKNIKE” që do të hapen publikisht në prani të përfaqësuesve të caktuar të Ofertuesve dhe kujtdo që zgjedh të marrë pjesë, në adresën e mëposhtme më **10 korrik 2024 në orën 14:15 (koha lokale)**.

Të gjitha zarfet me shënimin “PJESA FINANCIARE” do të mbeten të pahapura dhe do të mbahen të sigurta nga Punëdhënësi deri në hapjen e dytë të Ofertave publike.

7. Të gjitha ofertat duhet të shoqërohen me një Deklaratë të Sigurimit të Ofertës.
8. Vëmendje duhet t’i kushtohet Rregulloreve të Prokurimit që kërkojnë që Huamarrësi të shpalosë informacion mbi pronësinë përfituese të ofertuesit të suksesshëm, si pjesë e Njoftimit për Dhënie të Kontratës, duke përdorur Formularin e Zbulimit të Pronësisë Përfituese siç përfshihet në dokumentin e ofertimit.
9. Adresa e përmendura më sipër është:

**Agjencia Kadastrale e Kosovës**

Për vëmendje të: Specialisti i Prokurimit, REGIP.

Adresa: rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, Objekti i Arkivit, kati 2, 10 000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Email:

Për: [prokurimi.regip@rks-gov.net](mailto:prokurimi.regip@rks-gov.net)

Cc: [Muzafer.Qaka@rks-gov.net](mailto:Muzafer.Qaka@rks-gov.net)